

VENDIM
Nr.398, datë 21.6.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.560, DATË 12.8.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË UNIVERSITETET
DHE SHKOLLAT E LARTA PËR VITIN AKADEMIK 2005-2006, NË SISTEMIN ME
KOHË TË PLOTË, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR
KËTË VIT AKADEMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkences, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 11 të vendimit nr.560, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Studentët (gjithsej 14) e ardhur me kuota të ndërmjetme, për të vazhduar studimet në vitin e dytë, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, sipas marrëveshjes së 8 janarit, të nënshkruar në Ohër të Maqedonisë, dhe aneksmarrëveshjes së datës 2 qershor, të nënshkruar në Tiranë, do t’i nënshtrohen tarifës së studimit sipas kuotës kryesore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS

MARRËVESHJE

MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS SË REPUBLIKES SË MAQEDONISË

Në kuadër të nismave për bashkëpunim rajonal dhe të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit në fushën e arsimit ishte edhe Marrëveshja e lidhur me 8 janar 2005, në Ohër të Republikës së Maqedonisë, e cila kishte të bënte me zgjidhjen e problemit lidhur me studentët e ish-Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës.

1. Sipas kësaj marrëveshjeje, palët nënshkruese ranë dakord që, për zgjidhjen e problemit, të marrin përgjegjësi konkrete tre Universitetet shtetërore (i Prishtinës, i Tiranës dhe i Shkupit).

2. Në funksion të kësaj, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Shqipërisë ranë dakord që marrëveshja të ketë edhe disa shtesa, dhe konkretisht:

a) Numri i studentëve të parashikuar në vitin akademik 2004-2005 të jetë nga 46 në 57 (numri i kuotave të pranimit).

b) Numri i studentëve të parashikuar sipas pikës 4, të marrëveshjes së 8 janarit 2005, në Ohër “Në Universitetin e Tiranës 10 studentë”, të zëvendësohet me tekstin “Në Universitetin e Tiranës 14 studentë”. Bëhet fjalë për studentët që do të vijnë në vitin akademik 2005-2006 në vitin e dytë të studimit.

3. Meqenëse në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes, shteti Shqiptar nuk aplikonte tarifë shkollimi për kuotat e ndërmjetme dhe grupi i parë i studentëve të ardhur nuk i janë

nënshtuar kësaj tarife, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë. Ministri i Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, angazhohet për të kryer të gjitha procedurat për përjashtimin e këtyre studentëve nga tarifa e shkollimit.

4. Ministri i Arsimit dhe Shkencës i Shqipërisë zoti Genc Pollo, angazhohet për zbatimin e këtij aneksi marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë, më 2 qershor 2006.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Genc Pollo

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Aziz Polozhani